

**STATUT I SHOQERISE**  
**"General Work Contractor IT" Sh.P.K.**

Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.

Sot, me 11 Totor 2018, personat e meposhtem:

**COGEIR COSTRUZIONI E GESTIONI SRL**, shoqeri italiane me perjegjesi te kufizuar, regjistruar ne Regjistrin Tregetar te Italise, me seli ne Brindisi (BR), Komuna San Vito dei Normanni, Strada Provinciale Per Carovigno Z. I. CAP 72019, Itali, me NIPT IT- 01692910746, perfaquesuar nga Administratori i Vetem Vincenzo Francavilla, lindur me 06 Shtator 1963 ne Brindisi, Itali, shtetas italian, banues ne Itali, me kod fiskal FRNVCN63P06I396I, madhor e me zotesi te plete juridike e per te vepruar, identifikuar nepermjet dokumentit me nr. AT6230252, leshuar nga Komuna San Vito dei Normanni, dhe;

**GIMA COSTRUZIONI SRL**, shoqeri italiane me perjegjesi te kufizuar, regjistruar ne Regjistrin Tregetar te Italise, me seli ne Brindisi (BR), Komuna San Vito dei Normanni, Via Oberdan, zona artigianale CAP 72019, me NIPT IT-01720320744, perfaquesuar nga Administratori i Vetem Domenico Nigro, lindur me 21 Nentor 1981 ne Mesagne, Brindisi, Itali, shtetas italian, banues ne Itali, me kod fiskal NGRDNC81S21F152E, madhor e me zotesi te plete juridike e per te vepruar, identifikuar nepermjet dokumentit me nr. AV 9417592, leshuar nga Komuna San Vito dei Normanni, dhe;

**ICOST SRL**, shoqeri italiane me perjegjesi te kufizuar, regjistruar ne Regjistrin Tregetar te Italise, me seli ne Komuna Oria, Brindisi, Via Manzoni, 68/A CAP 72024, Itali, me NIPT IT-02202610743, perfaquesuar nga Administratori i Vetem Lorenzo Calo, lindur me 11 Mars 1968 ne Oria, Brindisi (BR) Itali, me kod fiskal CLALNZ68C12G098M, shtetas italian, banues ne Itali, madhor e me zotesi te plete juridike e per te vepruar, identifikuar nepermjet dokumentit me nr. YB3201198, leshuar nga Ministria e Jashtme Italiane, dhe;

**CONTE DOMENICO ENGINEERING SRL**, shoqeri italiane me perjegjesi te kufizuar, regjistruar ne Regjistrin Tregetar te Italise, me seli ne Komuna Palo del Colle (BA) Via Caracciolo, 21 CAP 70027, Bari, Itali, me NIPT IT-07107270725, perfaquesuar nga Administratori i Vetem Vito Conte, lindur me 19 Shkurt 1984 ne Bari, Itali, shtetas italian, me kod fiskal CNTVTI84B19A662Q, banues ne Itali, madhor e me zotesi te plete juridike e per te vepruar, identifikuar nepermjet dokumentit me nr. AS 8328117, leshuar nga Komuna Palo del Colle, dhe;

**Z. GURTEN PAPULI**, shtetas shqiptar, lindur me 21.05.1986 ne Tirane, Shqiperi, mbajtes i pasaportes nr. BG2940028 dhe numer personal ID I60521085A, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

ne përputhje me Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" dhe me legjislacionin e zbatueshëm ne Republikën e Shqipërisë, miratuan këtë Statut si vijon:

Në këtë statut:

- "Ligi" është Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
- "Statuti" është ky Statut i Shoqërisë;



The image shows four handwritten signatures in blue ink, each followed by a name in cursive script below it. From left to right: 1. A signature that appears to be 'H. R. D.' followed by 'H. R. D.'. 2. A signature that appears to be 'A. J.' followed by 'A. J.'. 3. A signature that appears to be 'F. N.' followed by 'F. N.'. 4. A signature that appears to be 'B. G. P.' followed by 'B. G. P.'

**Kreu I**  
**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1**  
**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, më 11 Tetor 2018, ne, themeluesit e mësipërm, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin dhe emërtimin tregtar "General Work Contractor IT" SH.P.K.

**Neni 2**  
**Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Furnizim me llampa LED ne tregun Shqiptar, konsulence, ndertim te aeroporteve dhe porteve, punime nenkontraktore, punime hidraulike, kanalizime dhe ujësjellësa, punime ndërtimore në përgjithësi dhe të gjitha aktivitetet duhet të kryhen në përputhje me rregullat dhe rregulloret e parashikuara.
- *Të gjitha aktivitetet duhet të kryhen brenda kufijve dhe në përputhje me rregullat dhe normat nga te cilat parashikohet ushtrimi i tyre.*

**Neni 3**  
**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e ***pacaktuar dhe/ose e pakufizuar***.

**Neni 4**  
**Selia**

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: *Rruga "Pjeter Bogdani", nr. 13, kati I, Njesia Bashkiake nr. 5, Tirane, Shqiperi.*

Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te hape dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

**Kreu II**  
**Kapitali**

**Neni 5**  
**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar filletar i shoqërisë është **LEKË 625.000 (gjashteqind e njezete e pese mijë leke)** ose ekuivalenti ne **EURO 5.000 (Pesemije euro)** dhe zotërohet tërësisht nga ortaket themelues si vijon:

- **COGEIR COSTRUZIONI E GESTIONI SRL:** Zotëruesh i **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme 132.813 Leke (Njeqind e tridhjete e dy mijë e tetëqind e trembedhjete leke) që përbën **21.25 % të kapitalit themeltar të shoqërisë**, dhe



- **GIMA COSTRUZIONI SRL:** Zotëruar i **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme 132.813 Leke (Njeqind e tridhjete e dy mijë e teteqind e trembedhjete leke) që përben **21.25 % të kapitalit themeltar të shoqërisë**, dhe
  - **ICOST SRL:** Zotëruar i **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme 132.813 Leke (Njeqind e tridhjete e dy mijë e teteqind e trembedhjete leke) që përben **21.25 % të kapitalit themeltar të shoqërisë**, dhe
  - **CONTE DOMENICO ENGINEERING SRL:** Zotëruar i **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme 132.813 Leke (Njeqind e tridhjete e dy mijë e teteqind e trembedhjete leke) që përben **21.25 % të kapitalit themeltar të shoqërisë**, dhe
  - **GURTEN PAPULI:** Zotëruar i **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme 93.750 Leke (Nentedhjete e Tremije e Shtateqind e Pesedhjete leke) që përben **15 % të kapitalit themeltar të shoqërisë**. Kontributi i ortakeve është në para.
- Secili ortak do te kete një numer proporcional votash me vleren nominale te kuotes se tij.

#### **Neni 6** **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund te zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### **Neni 7** **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: kontributit në kapitalin e shoqërisë; shitblerjes; trashëgimisë; dhurimit; çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj. Çdo disponim ne favor te një pale te trete nëpërmjet veprimeve juridike ndërmjet te gjallëve duhet te behet ne forme notariale dhe te regjistrohet. Ne rastet e transferimit te pjesëve te kapitalit me kundërshpërblim, ortaket e tjerë kane te drejtë e parablerjes.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

#### **KREU III** **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8** **Organë Vendimmarrës**

The image shows four handwritten signatures in blue ink, likely belonging to the members of the Board of Directors mentioned in the document. The signatures are: 'M. Bozzi' (top left), 'F. G. C. Papuli' (top right), 'D. Conte' (bottom left), and 'A. Icost' (bottom right). There is also a faint signature 'B. L. L. L.' in the middle.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te përcaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) shpérndarjen e fitimeve vjetore;
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### Neni 9

#### Mënyra e Thirrjes se Mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### Neni 10

#### Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.



Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **Neni 11 Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vodos me tri të katërtat e votave te zotëruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vodos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

### **Neni 12 Përjashtimi nga e drejta e votës**

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### **Neni 13 Administrimi**

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë për një mandat 5 (pesë) vjeçar emërimi: **Z. Vito Conte**, shtetas italian, lindur me 19 Shkurt 1984 ne Bari, Itali, me kod fiskal CNTVI84B19A662Q, banues ne Itali, mbajtës i kartës italiane te identitetit me nr. AS 8328117, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

**Kreu IV**  
**Viti finanziar-ekspertet**

**Neni 14**  
**Viti Financiar**

Viti finanziar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtmisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendrën Kombëtare te Biznesit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

**Neni 15**  
**Ekspertet**

Eksperti ka për detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit reportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'ia paraqesë e dorëzojë ne kohe ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore qe ka.

**Kreu V**  
**Prishja – Riorganizimi i Shoqërisë**

**Neni 16**  
**Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne çdo kohe: kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj; me vendim të Asamblesë se Ortakeve; me hapjen e procedurave të falimentimit; në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723/2007; me vendim të gjykatës.

Ne këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument të nxerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese "Shoqëri ne likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit që janë emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 17**  
**Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

A row of five handwritten signatures in blue ink, likely belonging to the audited entities mentioned in the document.

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

**Neni 18**  
**Baza Ligjore**

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne përputhje te plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqipërisë.

**Neni 19**  
**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqërisë dhe te tretëve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Për ndjekjen e procedurave te regjistrimit te shoqërisë ne Qendrën Kombëtare te Biznesit, autorizohet Znj. Egla Gjinolari dhe/ose Znj. Eni Mahmuti, te cilet mund te veprojne se bashku ose vecmas.

Ky akt u hartua ne gjuhen Shqipe dhe pasi u lexua, ne prani te përkthyeses se gjuhës italiane, u kuptua dhe u nënshkrua nga ortaket themelues si vijon:

**ORTAKËT THEMELUES**  
**TE SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"General Work Contractor IT" Sh.P.K.**


**ICOST SRL**

Perfaqesuar nga  
Administratori



**GIMA COSTRUZIONI SRL**

Perfaqesuar nga  
Administratori




**GURTEN PAPULI**



**CONTE DOMENICO ENGINEERING SRL**

Perfaqesuar nga  
Administratori



Përkthet  
Arbenim  
"Faq"

**COGEIR COSTRUZIONI E GESTIONI SRL**

Perfaqesuar nga  
Administratori

